



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenit 14, nenit 22 dhe nenit 24 të Rregullores për Marrëdhënien e Punës nr. 01-2978/22, të dt. 27.06.2022, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 01-2978/22, të dt. 28.03.2023 si dhe Vendimit të BtD me nr. 01-7502/25, të dt. 25.11.2025, Telekom i Kosovës SH.A shpall:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës:	Teknik i Ngrohjes dhe Klimatizimit 5.3.3.2.2.1
Ekzekutues:	2
Mandati:	3 vjeçar
Vendi:	Prishtinë
Ndërmarrja:	Telekomi i Kosovës SH.A
Kodi i strukturës:	CSK03_48
Grada:	B-6
Afati i fundit për aplikim:	04.06.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Është përgjegjës për servisimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të ngrohjes dhe klimatizimit në hapësirat administrative të objekteve të TK-së.
- I gatshëm të përgjigjet ndaj kërkesave nga udhëheqësi dhe njësitë tjera në orar 24/7.
- Në bashkëpunim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë përpilon planin javor, mujor dhe vjetor të shërbimeve operative për mirëmbajtjen, rregullimin dhe servisimin e sistemeve dhe instalimeve të ngrohjes dhe klimatizimit në hapësirat e objekteve të TK-së.
- Paraqet kërkesat për materialet e nevojshme dhe material shpenzues të nevojshëm për ngrohje dhe klimatizim.
- Implementon dhe mbikqyrë (sipas udhëzimeve dhe detyrës) investimet dhe rregullimet eventuale.
- Ndihmon në realizimin e punëve ndërlidhëse të projekteve për ngrohje dhe klimatizim.
- Bashkëpunon me zyrtarët kompetent të fushës brenda TK-së.
- Kryen edhe punë të tjera që kanë të bëjnë me fushëveprimin e njësisë.

Kushtet dhe kriteret që: **Teknik i Ngrohjes dhe Klimatizimit 5.3.3.2.2.1** duhet t'i plotësojë:

- Shkolla e mesme.
- 2 vjet përvojë pune përkatëse.
- Aftësi e dëshmuar në punët e mirëmbajtës së instalimeve, pajisjeve dhe stabilimenteve për ngrohje dhe klimatizim.
- Aftësi në ndarjen e prioriteteve dhe respektimin e afateve.
- Aftësi në marrjen e iniciativave, vendimeve dhe e punës nën presion të arritjes së afateve.
- Aftësi komunikuese dhe ndër personale.
- Aftësi e përdorimit të aplikacioneve aktuale kompjuterike (MS Office, Word, Excel, etj.).
- Kandidati duhet të jetë i/e lirë nga çdo konflikt interesi, siç përcaktohet me Ligjin për Konfliktin e Interesit 06/L-011.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për punësim/Aplikacioni (që mund të merret edhe online në www.kosovotelecom.com)
- CV e detajuar
- Letër motivuese
- Dëshmi punësimi (vërtetim) për çdo pozitë të mbajtur me data të sakta (merret në dep. të BNj-së)
- Dëshmitë e kualifikimit (diploma, certifikata, etj.)
- Nëse posedon Diplomë nga një shtet tjetër, kandidati duhet ta nostrifikojë atë.
- Certifikata e nxjerrë nga gjykata kompetente që vërteton se aplikanti nuk është nën hetime (jo më të vjetër se 6 muaj).

Dokumentacioni i lartcekur duhet të dorëzohet personalisht në zarf të mbyllur në zyrën e arkivit qendror në katin e VI-të, zyra nr.603, ndërtesa kryesore e TK SHA Dardania p.n.10000 Prishtinë, Republika e Kosovës ose në e-mail adresën hr@kosovotelecom.com

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

Për kualifikimin e kandidatëve dhe rezultatet e arritura në këtë proces të përzgjedhjes, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes e-mailit zyrtar hr@kosovotelecom.com brenda afateve të parapara ligjore.